

Hapur

#6

REVISTË PERIODIKE PËR BALLAFAQIM ME TË KALUARËN

Мислам дека и да не разбираш некои бајки,
можеш да ги разбереш само од чувствата



МИРОВНА АКЦИЈА
AKSIONI PAQËSOR
PEACE ACTION



HAPUR

revistë periodike për ballafaqim me të kaluarën

Aksioni Paqësor
2023

„HAPUR“
revistë periodike për ballafaqim me të kaluarë
ISSN: 1857- 9728

Redaktor i këtij numri:
Goran Taleski

Përkthimi:
Eniena Aeti, Ane Cesnoska

Lektura:
Ilir Ajdini, Julijana Taleska

Dizajn:
Aleksandar Dudeski

Fotografia në kopertinë:
Boro Kitanoski
(Skenë nga shfaqja “Largime” gjatë shfaqjes në Teatrin Kombëtar
“Vojdan Çernodrinski», Prilep - Qershor 2023)

Boton:
Aksioni Paqësor
Rr. Dimo Narednikot A1/2/31; Prilep
office@mirovnaakcija.org
www.mirovnaakcija.org

Shtypi:
Shtypshkronja Acetoni

Ky publikim është pjesë e programit Ballafaqimi me të Kaluarën të
“Aksionit Paqësor”, në bashkëpunim dhe me përkrahje të organizatës
«KurveVustrou» nga Gjermania, e financuar nga Ministria për Bashkë-
punim Ekonomik dhe Zhvillim e RF të Gjermanisë.



Aksioni Paqësor
2023

Hyrja

Për herë të parë që nga ekzistimi i revistës “Otvoreno/Hapur” kemi botuar dy numra brenda një viti. Para nesh është numri i gjashtë i revistës “Hapur”, ndërsa në korrik të këtij viti botuam numrin e pestë. Të dy botimet fokusohen në punën e Aksionit Paqësor në vitin 2023, vit ky i cili akoma po vazhdon. Viti ishte i mbushur me ngjarje dhe aktivitete të llojeve të ndryshme, për të cilat informojmë në këto dy botime. Rekomandohet të lexohen të dy numrat për të kuptuar më mirë se në çfarë ka marrë pjesë dhe ka kontribuar Aksioni Paqësor në proceset e ballafaqimit me të kaluarën dhe ndërtimit të paqes në Maqedoni dhe në rajon.

Le të fillojmë me një përkujtim të vogël të asaj që u botua në numrin e kaluar, dhe është e nevojshme që të kuptojmë vëllimin e punës së përfunduar këtë vit. Këto janë Parimet Kombëtare për Drejtësinë Tranzicionale, që u zhvilluan si rezultat i një procesi konsultimesh dhe seminaresh që organizuam në periudhën mars-prill 2023 me njerëz nga kategori të ndryshme: persona të zhvendosur brenda vendit, viktima dhe familje të viktimave, mësimdhënës, njerëz nga ish-zona të krizës, të rinj, aktivistë të paqes. Parimet kombëtare fokusohen në disa fusha kyçe: Sigurimi i hapësirës për zërin e viktimave dhe të marginalizuarve nga konflikti ushtarak; Kërkimi për të vërtetën (duke vërtetuar faktet); Memorializimi; Ndërtimi i besimit; dhe Fokusimi tek të rinjtë, dhe përmes tyre jepen udhëzimet të cilat shoqëria jonë do të duhej t'i miratonte për t'u përballur në mënyrë konstruktive me të kaluarën dhe për të ndërtuar paqen e qëndrueshme. Puna jonë në këtë plan nuk përfundoi në Maqedoni. Nëpërmjet një procesi të takimeve dhe konsultimeve rajonale me individë nga familjet e civilëve të vdekur, të zhvendosur, të zhdukur, të rinj dhe të tjerë, dhe në bashkëpunim të ngushtë me organizatat partnere Integra dhe Nisma e Re Sociale nga Kosova, Iniciativat Qytetare nga Serbia, si dhe PAKS nga Holanda dhe Qendra Ndërkombëtare për Drejtësinë Tranzicionale nga SHBA, krijuam gjithashtu Parimet Rajonale për Drejtësinë Tranzicionale.

Shfaqja “Zaminuvanja/Largime”, me regji të Dragana Gunin, me autorësi kolektive të regjisores dhe katër aktoreve që luajtën në të, është bazuar në dëshmitë nga librat “13 tregime grash për një luftë” dhe “Vatrat (Ognishta)” të botuar nga Aksioni Paqësor. Kjo dramë u shfaq në edicionin e 57-të të Festivalit Teator Maqedonas “Vojdan Černodrinski” - Prilep në seksionin e produksionit teator të pavarur nga autorë vendas. Ky ishte një nder i madh për ne nga Aksioni Paqësor që të vëmë shfaqjen në festivalin më prestigjioz të teatrit maqedonas dhe paraqet një nxitje për të ardhmen. Më gjerësisht për shfaqjen shkruan Marina Gjorgjioska Kitanoska.

Në këtë numër kujtojmë edhe ekspozitën “Të gjithë lotët tanë”, që kishte për fokus viktimat civile nga Serbia, Kosova dhe Maqedonia e Veriut. Ekspozita u prezantua në Beograd, Shkup dhe Prishtinë në vitin 2022, dhe në vitin 2023 u vendos edhe në Këshillin e Evropës në Strasburg, pasi që u propozua dhe u votua për t'u vendosur atje nga stafi dhe Klubi joformal i Arteve të Këshillit. Një vështrim të detajuar për ekspozitën mund ta gjeni në numrin e pestë të “Hapur”. Vështrimin për ekspozitën në këtë numër e ka shkruar Emrah Rexhepi, i cili edhe e koordinoi hapjen e ekspozitës në Këshillin e Evropës në Strasburg.

Në gusht u mbajt trajnimi bazë i katërmbëdhjetë me radhë për ndërtimin e paqes dhe përballjen me të kaluarën “10 Ditët e Republikës Paqësore”. Trajnimi ofron mundësi unike për zhvillim personal në më shumë fusha. Me përmbajtjen e vet dhe me kohëzgjatjen prej 10 ditëve, ai është i vetmi i këtij lloji në Maqedoni. Më shumë për trajnimin mund të lexoni në artikullin e Boro Kitanoski.

Një pjesë më të madhe të këtij numri ia kushtojmë “Programit për mbështetjen e mësimdhënësve të historisë për përgatitjen dhe zbatimin e aktiviteteve jashtëshkollore për ndërtimin e paqes”. Programi në tërësi u zbatua në vitin 2023 në bashkëpunim me Asociacionin e Mësimdhënësve të Historisë në

Maqedoni (ANIM) dhe në të morën pjesë 8 mësime të historisë nga 4 shkolla fillore dhe 3 të mesme nga Maqedonia. Filluam me dy trajnime, që u realizuan në prill dhe korrik 2023, pas çka pasoi zbatimi i aktiviteteve nga shkollat partnere në periudhën shtator - nëntor 2023. Fazën e fundit të programit e realizuam në dhjetor 2023 kur bëmë një vlerësim gjatë një takimi të përbashkët përfundimtar në Prilep. Lexoni më shumë për programin, nevojat për të cilat e filluam, qëllimet dhe rezultatet, në artikullin e posaçëm dedikuar këtij qëllimi, autor i të cilit është Goran Taleski. Në vazhdim të këtij artikulli, kemi edhe katër artikuj për aktivitetet jashtëshkollore të kryera nga pedagogët me nxënësit e tyre. Artikujt, bazuar në raportet e mësimeve, janë shkruar nga Emrah Rexhepi, Marina Gjorgjioska Kitanoska dhe Katarina Shmic.

Meqë veç jemi te resurset të cilat stafit mësime i historisë i kishte në dispozicion, në këtë numër të “Hapur”, paraqesim një “Doracak për aktivitetet jashtëshkollore në lëndën e Historisë për arsimin fillor dhe të mesëm”. Doracaku përmban 8 aktivitete jashtëshkollore që mund të kryhen në takime të përbashkëta ose duke përdorur platforma online për bashkëpunim (Zoom, MS Teams...) dhe janë të dedikuara për aktivitete në lëndën e Historisë.

Pas një pritjeje të gjatë, këtë vit gjetëm rastin të ribotojmë librin “Të rritesh me luftën”. Libri u botua në pranverën e vitit 2009, dhe prej kohësh kemi kërkuar mënyrë për ta ribotuar atë, me korrigjime të bëra në gjuhën e intervistave dhe me korrigjim të gabimeve gjatë përkthimit. Por, mbi të gjitha, ne ndjemë se ky libër, i cili përmban intervista me njerëz të rinj gjatë luftës, meritonte një jetë të dytë. Lexoni më shumë në artikullin e veçantë mbi këtë temë.

2023-shi ishte gjithashtu viti në të cilin ekipi i Aksionit Paqësor përkujton ardhjen e Katarina Shmicit në cilësinë e punonjëses ndërkombëtare të paqes në zyrën tonë. I urojmë mirëseardhje dhe shumë suksese në punën e saj dhe në punën tonë të përbashkët. Katarina Shmic është autorja e të vetmit tekst që nuk lidhet në mënyrë strikte me punën e Aksionit Paqësor në këtë numër. Katarina shkroi një artikull informues rreth përpjekjeve për t'u përballur me të kaluarën dhe për të ndërtuar paqen në Nepal, një vend që u godit nga lufta civile në vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar.

Në fund të kësaj hyrjeje, do të kisha dashur t'i falënderoj partnerët tanë KURVE Wustrow nga Gjermania, mbështetja e të cilëve ka qenë e një rëndësie vendimtare për punën tonë të qëndrueshme dhe të suksesshme gjatë gjithë këtyre viteve, organizatat partnere nga Konzorciumi në të cilin, së bashku me Aksionin Paqësor, Iniciativat Qytetare (Serbia), Integra-n dhe Iniciativën e Re Sociale (Kosovë), PAKS (Holandë) dhe Qendrën Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale (SHBA) realizuam projektin “Forcimi i zërit të viktimave nëpërmjet përfshirjes dhe transformimit të narrativeve”, partnerët tanë nga Qendra për veprim jo të dhunshëm në Sarajevë/Beograd, Asociacionin e Mësimeve të Historisë në Maqedoni (ANIM) dhe mësimeve të historisë të përfshirë në proceset tona, aktorët, regjisorja dhe ekipin që e realizoi shfaqjen “Zaminuwanja / Largime”.

Me shpresë se viti 2024 do të jetë edhe më i suksesshëm, ekipi i Aksionit Paqësor

Goran Taleski

Boro Kitanoski

Emrah Rexhepi

Marina Gjorgjioska Kitanoska

Katarina Shmic

Shfaqja teatrale «Largime»

Arti në funksion të përballjes me të kaluarën dhe ndërtimit të paqes

Lehtësia e heshtjes dhe shmangia e shqetësimit kur nuk diskutohet e kaluara në një shoqëri çon në harresën e kujtimeve. Ky qëndrim ndaj të shkuarës nuk është shërues. Përkundrazi, shkakton dëme, jo vetëm në planin personal, por edhe në atë shoqëror.

Ndërtimi i paqes nuk është një thirrje e lehtë, megjithëse qëllimi përfundimtar është fisnik, i singertë dhe me respekt ndaj të gjithë të përfshirëve në proces. Në anën tjetër, të flasësh për luftë, në shoqëritë që janë të paqëndrueshme dhe të brishta për shkak të veprimeve ushtarake të kohëve të fundit ku viktimat civile kërkojnë drejtësi, është, të paktën, traumatike.

Sikleti kur flasim për të kaluarën është gjithmonë i madh, pasi kjo është temë e nxehtë dhe nuk është e lehtë për t'u duruar. Është e natyrshme që njerëzit t'i shmangen kësaj teme, por kur edhe institucionet heshtin, me këtë sjellje të papërgjegjshme kontribuojnë për harresën e shoqërisë. Andaj, kërkimi për drejtësi nga ana e viktimave është i pafund, deri në momentin kur nga lodhja, pikëllimi dhe shqetësimi gjithçka të heshtë. Ndërsa heshtja është më e rënda.

Një nga mënyrat për të folur, për t'u dhënë hapësirë njerëzve që janë gjetur në mes të luftës pa fajin e tyre, është të kujtosh në mënyrë konstruktive. Duke bërë këtë, ne përpiqemi të mos shkaktojmë trauma dhe dhimbje shtesë. Ky është detyrimi ynë. Kështu, Aksioni Paqësor, ndër të tjera, mbledh histori jetësore, dhe nëpërmjet tyre ofron hapësirë për kujtime, jep mundësinë për të mos heshtur, për të mos harruar.

Së fundmi, jemi duke shqyrtuar mundësinë e përdorimit të artit si mjet për të folur dhe komunikuar me njerëzit, kur flasim dhe ndajmë mendime për tema të vështira. Kështu, në kuadër të një iniciative rajonale për të mbështetur dhe punuar me viktimat civile të luftërave nga ish-Jugosllavia, na lindi ideja për të mbështetur një shfaqje teatrale së bashku me bashkëpunëtoreshen, miken dhe regjisoren tonë të vjetër Dragana Gunin.



Dragana Gunin –
drejtoreshë, aktiviste,
feministe, psikologe

“Singërisht, nuk është e vështirë vetëm për aktorët, por edhe për të gjithë grupin. Procesi i rritjes dhe të kuptuarit kur hapen tema të tilla është i madh. Jam krenare për faktin që kemi punuar në dy gjuhë dhe që nuk kemi pasur fare pengesa. Arti edhe një herë tregon se emocioni është segmenti më i rëndësishëm dhe forca lëvizëse te njerëzit.” – Dragana Gunin (marrë nga një intervistë për Storyland nga 30 dhjetori 2022¹.)

1 <https://storyland.mk/dragana-gunin-za-zaminuva%D1%9Aa-ta-shto-se-sluchi%D1%98a-od-dvete-strani/>

“Unë thjesht dua që të jetë qetë. Dua të fle”

Një shfaqje që askush as që e kishte ëndërruar. Dhe një ëndërr nga e cila të gjithë u zgjuan, por askush nuk e tregoi.

2001. Dy anë. Një dhimbje. Njëqind fytyra dhimbjeje. Dhe një milion histori. Shfaqje për luftën e vitit 2001, e treguar nëpërmjet përvojave të grave nga të dyja anët. Bazuar në ngjarje të vërteta.

Këto fjalë e përshkruajnë dhe prezantojnë shfaqjen “Largime”. Shfaqja është autorësi kolektive, e drejtuar nga Dragana Gunin. Bazuar në dëshmitë nga librat “13 tregime grash të një lufte” dhe “Vatrat” botuar nga Aksioni Paqësor.

Regjisore: Dragana Gunin; Skenografia: Martin Gijevski; Kostumografia: Natasha Stojčevska; Autor i muzikës: Gala Naseva; Dizajni i dritës: Idaver Xhemaili

Luajnë: Emilia Micevska, Melika Kastrati, Simona Dimkovska, Afrodita Xhaferi

Kjo shfaqje është e para, ose të paktën nuk kemi dëgjuar për një tjetër, që trajton luftën e vitit 2001. Realizohet në dy gjuhë, në shqip dhe maqedonisht. Aktoret i kapin personazhet në një mënyrë autentike dhe krijuese, secila duke folur gjuhën e personazhit që po interpreton. Nëpërmjet rrëfimit të historive të 4 personazheve femra, publiku ka mundësinë të bashkëndjejë me dëshmitë, humbjet, me ndjenjat dhe emocionet, me interpretimet e ndryshme të një lufte. Është krenari dhe nder të punosh me një grup kaq të përkushtuar aktoresh kureshtarë dhe të motivuara nën mentorimin e regjisores Gunin.

Nga bisedat tona me aktoret mësojmë se edhe vetë krijimi i shfaqjes ka qenë një proces mësimi, kërkimi, bashkëndjesie, njohjeje dhe gjithësesi i krijimit të miqësive shumë të forta. Për aktoret, procesi i krijimit të personazhit apo personazheve ishte një sfidë emocionale dhe një detyrë e përgjegjshme, sa që në fund u kthye në një projeksion të një personi që tregon se si e ka përjetuar luftën. Kështu, secila prej aktoreve në mënyrë autentike i jep hapësirë publikut, që të bashkëndjejë me personazhet sipas pikëpamjeve të veta. Edhe pse shfaqja është luajtur në maqedonisht dhe shqip, nuk fitohet përshtypja se ka nevojë për një përkthim. Siç do të thotë Zvonko Dimoski, “performanca komunikon me publikun, pavarësisht nëse ka apo nuk ka përkthim”.

Shfaqja në Shkup dhe Kumanovë

29 dhjetor 2022, në Teatrin Shqiptar - Shkup. Premiera e shfaqjes.

21 mars 2023 – repriza e parë, Teatri Shqiptar – Shkup

22 maj 2023 – repriza e dytë, Teatri i Kumanovës



Nga premiera e shfaqjes - Shkup, 2022
Autor: Stojan Raskov

Nga premiera e
shfaqjes - Shkup, 2022
Autor: Stojan Raskov



Shfaqja e festivalit në Prilep, 11 qershor 2023

“Mendoj se edhe nëse nuk i kupton disa përralla, mund t’i kuptosh vetëm nga ndjenjat”

Shfaqja u përzgjodh në produksionin e pavarur që inskenon autorë maqedonas në edicionin e pesëdhjetë e shtatë të Festivalit të Teatrit Maqedonas “Vojdan Çernodrinski”. Kjo kategori prezantohet për herë të parë para publikut teatror në kuadër të Festivalit në vitin 2023.



Nga premiera e
shfaqjes - Shkup,
2022.

Nga e majta në të
djathtë: Simona
Dimkovska, Emilia
Micevska, Melika
Kastratii, Afrodita
Xhaferi
Autor: Dragan
Ristovski


Diskutim për shfaqjen me publikun, pas shfaqjes në Prilep në teatrin “Vojdan Çernodrinski”.

Shfaqjen e quajta: Dramë e angazhuar në mënyrë performative - Zvonko Dimoski, veprimtar, përkthyes, kulturolog, drejtues i radio-emisioneve - autor i tekstit për shfaqjen në Buletinin nr. 2. 57, Festivali Teatror Maqedonas “Vojdan Çernodrinski”, Prilep



Diskutim për shfaqjen me publikun, pas shfaqjes në Prilep në teatrin «Vojdan Chernodrinski» - qershor 2023
Autor: Boro Kitanoski

Zvonko Dimoski



LARGIME, AKSIONI PAQËSOR (PRODUKSION I PAVARUR) – KOLEKTIV AUTORËSIA²

«Largime», e ndërtuar si shfaqje skenike e angazhuar, trajton temën e luftës, duke përdorur kujtimet e 13 grave, të ngujuara mes heshtjes dhe harresës, dhe dhimbjes së tyre, të vendosur në një vakum midis së kaluarës dhe së tashmes. Autorët dhe regjisorja Gunin, duke lexuar intervistat e mbledhura nga “Aksioni Paqësor” si material, duke u përballur me traumat e njerëzve të tjerë dhe duke kapërcyer konventat shoqërore për shkak të të cilave, jo vetëm bota, por edhe ne vetë shumë shpejt fillojmë t’i harrojmë luftërat dhe shpejt mësohemi me harresën (tonën dhe të të tjerëve), afrojnë një temë dukshëm të heshtur nga historia jonë më e re, pra konflikti ushtarak i vitit 2001, të rrëfyer në skenë nga katër aktore, në maqedonisht dhe shqip.

Atmosfera e përgjithshme në të cilën ndërtohet kjo procedurë tërheqëse, nëpërmjet rrëfimeve të sjella nga katër aktoret, fokusohet në përjetimin e një teme që i lidh dhe i bën të barabarta, megjithëse paraprakisht mund lehtësisht të mendojmë se tema e luftës nuk mund ta prekë secilën prej tyre në mënyrë të barabartë. Vetëm se qasjet ndaj përballjes me traumën dhe emërimit të luftës janë të ndryshme, gjë që tregon gjithashtu se përcaktuesit lokalë të konfliktit në fjalë kanë kuptim. Ndonjëherë ndryshimi i rrethanave thyen heshtjen dhe çliron kujtimet, dhe ndonjëherë heshtja zgjat aq shumë sa kujtimi zbehet dhe harresa pason. “Largime”, tregojnë se heshtja dhe harresa shpesh ngatërrohen kur kujtesa analizohet si rrëfim. Ajo që nuk u tha mund të mbetet e pathënë/e harruar, ose për shkak se ka qenë e shtypur për shkak të traumës, kontrastit me të tashmen, ose për shkak të konfliktit midis individit dhe kolektivit - ose për shkak se kushtet për ta thënë nuk ekzistojnë më, ose ende nuk janë shfaqur.

Bisedë për procesin e krijimit të shfaqjes, për shfaqjet e dramës dhe për ndërtimin e personazheve, për perspektivat e grave dhe qëndrimin shoqëror ndaj luftës së vitit 2001 me Zvonko Dimoski – radio-emision për shfaqjen. Radio Pella – 29 qershor 2023

Pas prezantimit të shfaqjes në Prilep, patëm nderin të ishim mysafir në Radio Pella, në një emision me Zvonko Dimoskin. Videoja e plotë është në dispozicion në kanalën e radios në YouTube.

Emisioni në radio emetohej drejtpërdrejt, ndaj dëgjuesit patën mundësinë të komentojnë dhe të shkruajnë mendimet e tyre për bisedën gjatë zhvillimit të emisionit.

Kur dëgjova emisionin kuptova se përveç aktualizimit të një teme që nuk diskutohet shpesh në shoqëri, një temë e vështirë, kjo paraqet edhe diçka fort edukative, e sinqertë dhe me shumë emocione. Shfaqja komunikon me një publik, orekset e të cilit janë: kurioziteti për të parë shfaqjen, kritika teatrale, si dhe njohuri profesionale dhe personale në proceset e zhvillimit të personazhit të viktimës në luftë bazuar në dëshmitë personale. Dhe e gjithë kjo nuk do të ishte paraqitur në këtë mënyrë për publikun e radios pellagoniase, nëse aktoret dhe regjisorin nuk do të ishin profesionistë por edhe autentikë dhe të parëzervë për të gjitha përgjigjet dhe mendimet për të cilat ishte kurioz autori dhe drejtuesi i emisionit, jo vetëm si kritik teatri, por edhe si aktivist që hapi një temë për të cilën heshtet, ose të paktën nuk është shpesh e pranishme në media.

Rekomandim i sinqertë për të ndjekur emisionin në kanalën YouTube të Radio Pellës.

Marina Gjogjioska Kitanoska

² <https://mtf.com.mk/57-mtf-bilten-2/>

Çfarë thanë aktoret dhe regjisori për aspektet e ndryshme të shfaqjes.



“Si është t’i japësh zë diçkaje që e kemi lexuar, njerëzve të vërtetë? Ishte një sfidë për mua, sa e frikshme, aq edhe e përgjegjshme, jo vetëm si aktore, por edhe si person, sepse është e vërtetë ... t’i japësh zë diçkaje që ka 20 vite pa zë”.

Simona Dimkovska – aktore

“Procesi i krijimit të personazhit tim ishte i vështirë dhe sfidues, sepse ishte shumë larg, nuk ishte diçka që e kisha përjetuar, por fatmirësisht kisha shumë të afërm me të cilët komunikoja dhe ata më ndihmuan. Me rëndësi është të tregohet ana e gruas në luftëra, dhe mendoj se pikërisht historitë e grave komunikojnë më shumë me të rinjtë”.

Melika Kastrati – aktore





“Njerëzit që nuk e kanë ndjerë luftën nuk kanë kurrfarë qëndrimi: se diçka ka ndodhur, se dikush ka vuajtur, dikush është viktimë... dhe sfida ishte të hulumtojmë gjithçka që mundemi dhe të jemi konsekuente me fatet e jetës së dikujt dhe të tregojmë dhimbje, edhe për ata që nuk janë të prekur drejtpërdrejt.

Do të jem shumë e lumtur nëse është diçka edukative, nëse është e dobishme për ata që nuk e njohin këtë temë, sepse këto histori duhet t'i dëgjojnë të gjithë”.

Emilia Micevska - aktore

“Si aktorë, gjatë studimeve tona ne mësojmë se si të ndajmë emocionin privat nga emocioni skenik. Ndonëse, gjatë provave kishte momente që nuk mund të ndalonim emocionet tona, private, lidhur me atë që lexonim.

Duhet që audiencës t'i rrëfëhet tema nga një aspekt neutral, nga një aspekt ku ti tregon vetëm atë që ka ndodhur, çfarë u ka ndodhur shumë njerëzve në atë periudhë”.

Afrodita Xhaferi - aktore



“Reagimet janë të ndryshme, por janë gjithmonë të forta. Dhe ajo që kam vënë re është se më së shumti marr komente për temën, dhe jo për zhvillimin e temës, që ndonjëherë edhe mua më duhen si regjisore. Kryesisht flitë për temën dhe kuptova se tema është më e madhe se shfaqja, se ideja është më e madhe dhe se për këtë duhet të tregohet, të punohet vazhdimisht, në mënyrën më të drejtë të mundshme, kolektivisht, se ajo kërkon qasje pak më serioze”.

Dragana Gunin - regjisore

“TË GJITHË LOTËT TANË”

EKSPOZITË RAJONALE KUSHTUAR VIKTIMAVE CIVILE

Konzorciumi i përbërë nga Aksioni Paqësor (MK), Iniciativa Qytetare (Serbia), INTEGRA dhe Iniciativa e Re Sociale (Kosovë), PAX (Holandë) dhe Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale (SHBA), së bashku me katër fotografë profesionistë, ideuan dhe krijuan ekspozitën rajonale **“Të gjithë lotët tanë.”** Ekspozita përbëhet nga 34 fotografi autoriale, të realizuara nga katër fotografë në vende të ndryshme në Serbi, Kosovë dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kjo ekspozitë unike i kushtohet historive të viktimave të luftërave në rajon. Tregimet paraqesin aspekte të shumta të luftërave në ish-Jugosllavi: fotografi familjare të personave të zhdukur, skena krimi, varre masive, persona të zhvendosur brenda vendit dhe memoriale, por edhe pasojat afatgjata të konflikteve që ende ndjehen sot, duke treguar të gjithë tragjedinë dhe kompleksitetin e luftës.


Ekspozita është bërë në bashkëpunim me organizatat e familjeve të personave të zhdukur dhe të vdekur nga Serbia dhe Kosova, si dhe familjet e civilëve të vdekur dhe të zhvendosur nga Maqedonia, me qëllim që të hapen hapësira për mundësi të reja dhe iniciativa të përbashkëta në drejtim të ndërtimit të paqes dhe pajtimit në rajon.

Hapja e parë e ekspozitës sonë ishte në **Beograd, më 25 maj të vitit 2022**, ku u hap edhe festivali tradicional “Mirdita – Dobar Dan”. Hapja jonë e dytë ishte në **Shkup, më 12 tetor 2022**. Kryetari i shtetit, Stevo Pendarovski mori pjesë dhe e shpalli të hapur ekspozitën. Hapësira e tretë e ekspozitës ishte në **Prishtinë, më 10 dhjetor 2022**, ku mori pjesë dhe hapi ekspozitën ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu.

Shfaqja e katërt, edhe pse e paplanifikuar fillimisht, ishte më **7 prill të vitit 2023 në Këshillin e Evropës në Strasburg**, pasi u propozua dhe u votua për t'u vënë në skenë atje nga të punësuarit dhe nga Klubi joformal i Arteve pranë Këshillit. Këtë ekspozitë e hapi ambasadorja e BE-së në Këshillin e Evropës, Vesna Batishiq-Kos.

Fotografë profesionistë: Arbnora Memeti (MK), Nake Batev (MK), Atdhe Mula (Kosovë) dhe Borislav Peshiq (Serbi).

Emrah Rexhepi



Poster për ekspozitën «Të gjithë lotët tanë»

10 Ditë Republikë Paqësore, 2023

Në periudhën 19-29 gusht 2023, në Hotelin “Montana” në Krushevë u mbajt trajnimi themelor, i katërmbëdhjeti me radhë, për ndërtimin e paqes dhe përballjen me të kaluarën “10 Ditë Republikë Paqësore”, organizuar nga Aksioni Paqësor. Trajnimi u organizua nga ekipi i trajnerëve, në përbërje: Andrea Velinova, Emrah Rexhepi, Boro Kitanoski dhe Goran Taleski.

Në trajnim u përfshinë 19 pjesëmarrës të ardhur nga vende të ndryshme të Maqedonisë, me prejardhje të ndryshme etnike dhe fetare, të gjinive të ndryshme dhe me shumë identitete të tjera. Një tipar specifik i këtij grupi ishte dallimi në moshë. Kjo, nga njëra anë, paraqet sfidë gjatë punës, por në anën tjetër, është një përfitim që u tregua në disa raste gjatë trajnimit. Kryesisht, pasi që kjo pasqyron shoqërinë në të cilën jetojmë dhe diskutimi midis brezave është shumë i rëndësishëm, ndërsa rrallë ndodh. Por përfitimet u panë edhe në disa raste të tjera. Dhe në këtë trajnim ra në sy pjesëmarrja e mësueseve femra, si dhe e një grupi shumë të fortë të të rinjve që sollën energji, mendim dhe qasje të thelluar ndaj temave.

Gjatë trajnimit punuam në këto tema: Prezantimi dhe njohja me njëri-tjetrin, Komunikimi jo i dhunshëm, Bashkëpunimi dhe puna ekipore, Vendimarrja, Të kuptuarit e konflikteve, Dhuna, Paragjykitimi dhe diskriminimi, Gjinia, Identitetet dhe identiteti etnik, Përballja me të kaluarën (e punuam në 3 blloqe), Zgjidhja kreative e konflikteve dhe Veprimi jo i dhunshëm, pasuar nga një seancë vlerësimi dhe dalje nga trajnimi. Ekipi i trajnerëve u përpoq ta përshtatë programin sipas nevojave të identifikuara të grupit dhe menaxhoi proceset me sukses.

Reflektimet e jetës së përditshme duken qartë në trajnime dhe për këtë arsye çdo trajnim është i veçantë dhe i ndryshëm nga të tjerët dhe secila nga temat përpunohet në mënyrë të veçantë. Jetojmë në një kohë kur shumica e diskutimeve politike zhvillohen online, në rrjetet sociale, ku janë vendosur shabllone të caktuara sjelljeje dhe argumentimi, por edhe shprehi të shfrytëzimit, përdorimit dhe keqpërdorimit të tyre. Disa nga këto shprehi u pasqyruan në proceset e trajnimit dhe grupi u përball me vendime për t'i kapërcyer ato. Disa tema, për fat të keq, janë të mbingarkuara në diskutimet online dhe i



Trajnim për përballjen me të kaluarën dhe ndërtimin e paqes - Krushevë, 2023
Autor: Boro Kitanoski

nënshtrohen valëve globale të interesit që ofrojnë cilësime të paracaktuara për «debat», të cilat në fakt kanë detyrë krejtësisht të kundërt - të ndalojnë debatin dhe t'i mbajnë “palët” e ngulitura në pozicionet e tyre “armiqësore”. Në trajnim u përpoqëm t'i shpalojmë shabllonet e tilla të sjelljes në mënyrë që të hyjmë në diskutim të vërtet rreth temave dhe të ndërtojmë marrëdhënie mbi baza të reja që do të mundësonin shkëmbim të hapur, por edhe mundësinë e empatisë dhe solidaritetit. Ato ishin sfida: për disa tema ia dolëm, për disa më pak, dhe kishim çaste kur ishte e vështirë. Por, shpresojmë për një efekt kumulativ, çfarë trajnimet e tilla në të kaluarën na kanë treguar se e kanë dhe se kemi mbjellë disa fara dyshimi që do të mbijnë në të ardhmen.



Trajinim për përballjen me të kaluarën dhe ndërtimin e paqes - Krushehtë, 2023
Autor: Boro Kitanoski

Ky lloj i paketave të paracaktuara, të mbledhura kryesisht nga interneti, ishte i dukshëm kur trajtuam temën e gjinisë (përveç vendosjes së saj në një bllok të veçantë, e gërshetuam edhe në pothuajse të gjitha temat, sepse e konsiderojmë si qendrore në çështjet e rendit, militarizmit dhe nacionalizmit). Por, thjesht, jetojmë në një epokë trazirash globale dhe abuzimesh me vetë temën e identiteteve gjinore dhe është e pritshme që ato të pasqyrohen sa herë që i tundim. Por, në anën tjetër, diversiteti i brezave solli shumë njohuri të rëndësishme pikërisht në sesionin gjinor. Si nga ana vizuale ashtu edhe nga ajo përmbajtësore, ishte një moment shumë mbresëlënës situata në të cilën disa breza grash qëndrojnë pranë njëra-tjetrës dhe ndërlidhen mes vete për mekanizmat e shtypjes dhe fitimin e lirive ndër vite në të kaluarën.

Siç rridhte trajnimi, grupi adoptoi mekanizmat e veta të funksionimit, kështu që pavarësisht sfidave më serioze kur u futëm në temën e Përballjes me të kaluarën, puna në grup funksionoi. Zbërthimi kreativ i konfliktit ishte ndikoi në mënyrë çliruese dhe ishte një hyrje e mirë në Veprimin jo të dhunshëm.

Ky ishte një trajnim i suksesshëm, me sfida të fuqishme, por edhe pjesëmarrëse dhe pjesëmarrës shumë të fortë me të cilët jemi të sigurt se do të mbetemi në kontakt edhe në të ardhmen. Ne i ndiejmë ata si aleate dhe aleatë me të cilët me shumë dëshirë do të bashkëpunojmë.

Boro Kitanoski
11/2023

Program për mbështetje të mësimeve të historisë për përgatitjen dhe realizimin e aktiviteteve jashtëshkollore për ndërtimin e paqes

Programi për mbështetje të mësimeve të historisë për përgatitjen dhe realizimin e aktiviteteve jashtëshkollore për ndërtimin e paqes përbëhet prej dy trajnime për mësuesin, përgatitjes dhe realizimit të aktiviteteve jashtëshkollore në lëndën e historisë dhe një takim përfundimtar i punës për vlerësimin e asaj që është bërë. Programi u zbatua në tërësi në vitin 2023 në bashkëpunim me Asociacionin e Mësimeve të Historisë në Maqedoni (ANIM). Në vazhdim mund të lexoni më në detaje rreth kontekstit social dhe arsimor për të cilin kemi zbatuar këtë program dhe planifikojmë të vazhdojmë punën në këtë fushë.



Realiteti në Maqedoni është se jetojmë në një shtet, por me shoqëri të ndara. Mundësitë dhe hapësirat për komunikim dhe hapësirat për diskutime për tema më të vështira të natyrës etnike janë minimale, thuajse joekzistuese, kypce pikërisht këto janë trajtësues shumë të fortë të shtetit. Tensionet etnike nuk janë të vogla dhe janë vazhdimisht të pranishme. Ky realitet pasqyrohet rregullisht në arsim. Kemi segregacion të qartë në arsim në baza etnike. Një numër i madh shkollash që ishin, ose funksiononin së bashku, u ndanë. Kemi shkolla me paralele me bashkësi të ndryshme etnike, por shumë shpesh ato janë me ndërrime të ndryshme – që paraqet edhe një formë të ndarjes. Pra, mundësitë që fëmijët të komunikojnë, mundësitë për të bërë diçka së bashku, për të luajtur së bashku, janë minimale. Por, nga kjo situatë nuk duhet të ikim. Procesi i segregacionit nuk është i ri.

Vizitë në muzeun «11 tetor 1941» - Prilep, 2023
Ljupka Hristova, mësimeve të historisë
Autor: Boro Kitanoski

Lënda e historisë në shkollat fillore dhe të mesme nuk është imune ndaj situatës në të cilën jetojmë. Tekste të vjetra, mësimdhënie me metoda të vjetruara dhe pa hapësirë shkëmbimi mes nxënësve që mësohen në gjuhë të ndryshme për tema historike me interes të përbashkët. Është e vërtetë se programi dhe tekstet shkollore për historinë, si dhe për të gjitha lëndët e tjera, janë të njëjta për të gjithë nxënësit në vend, pavarësisht gjuhës në të cilën mësojnë dhe komunitetit etnik që i përkasin. Megjithatë, mësimdhënësit kanë lirinë të zgjedhin një përqindje të caktuar të mësimëve nëse do t'i përfshijnë ato në procesin mësimor apo jo. Më shpesh, mësimet që hidhen janë mësimet me fokus në bashkësitë e tjera etnike, kështu që kjo mënyrë bazë e njohjes së “tjetrit” nuk përdoret dhe lihet mënjanë. Dhe kjo është ajo që mungon veçanërisht.



Vizitë në muzeun «11 tetor 1941» - Prilep, 2023

nga e majta në të djathtë: Mire Mladenovski (ANIM), Rubiņo Belçeski (kurator i muzeut), Goran Taleski (MA), Marina Gjorgioska Kitanoska (MA)

Autor: Boro Kitanoski

Prandaj, është me interes të madh zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta kurrikulare dhe jashtëshkollore me fëmijë të etnive të ndryshme, ku fëmijët mësojnë së bashku, e mbi të gjitha, të njohin dhe komunikojnë me njëri-tjetrin. Një nga problemet kryesore në zbatimin e këtij procesi është mungesa e komunikimit mes vetë mësimdhënësve. Përmes këtij programi, u përpoqëm të ndikojmë në këto situata, brenda mundësive tona.

Bisedimet fillestare mbi programin e trajnimit filluan në dhjetor 2022 midis Aksionit Paqësor dhe ANIM. Pasi një periudhë e përcaktimit të nevojave dhe mundësive, kështu që deri në mars të vitit 2023 u përzgjedhën shkollat dhe mësimdhënësit që do të ftohen të jenë pjesë e procesit. Vendosëm që të përfshijmë mësimdhënësit të historisë që tashmë kishin bashkëpunuar me Aksionin Paqësor ose ANIM, edhe atë nga një mësimdhënësi nga katër shkolla fillore dhe nga katër shkolla të mesme. Gjithashtu formuam ekipin e trajnerëve, të përbërë nga Boro Kitanoski, Emrah Rexhepi, Mire Mladenovski dhe Goran Taleski. Përgatitjet për fazën e parë filluan në muajin mars dhe trajnimin me mësimdhënësit e zhvilluam në periudhën 7-9 prill 2023 me pjesëmarrjen e 8 mësimdhënësve nga 4 shkolla fillore dhe 3 të mesme.

Agjenda e trajnimit të parë përbëhej nga prezantimi i idesë për Programin, puna në kontekst, formimi i çifteve të mësimdhënësve për bashkëpunim në të ardhmen dhe shkëmbimi fillestar i ideve për aktivitete. Këtu do të veçonim punëtorinë për kontekstin, përmes së cilës analizuam mësimet në tekstet e historisë për shkollat fillore dhe të mesme. Fokusi i teksteve të historisë është prezantimi i historisë së popujve që jetojnë në Maqedoni, e cila nuk është e njëjtë me historinë e Maqedonisë. Mësimdhënësit folën për përvojat e tyre në lidhje me zgjedhjen e mësimëve që japin (për arsimin fillor) dhe mundësinë që nëpërmjet kësaj zgjedhjeje të ndikohet fuqishëm në nxënien ose mosnxënien e mësimëve që u referohen popujve të tjerë. Përvojat thonë se secili mëson për veten e tij, mbi të gjitha për njerëzit e tij, dhe mësimet që jepen janë të këqija dhe të vjetruara.

Trajnimi i dytë në program u zhvillua në periudhën 3-5 korrik të vitit 2023. Fokusi i kësaj faze ishte përgatitja e aktiviteteve jashtëshkollore që do të realizohen nga mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollave pjesëmarrëse. Ekipi i trajnerëve përgatiti udhëzues të përshtatshëm për përgatitjen e aktiviteteve. Mësimdhënësit punuan në dyshe për zhvillimin e ideve të fazës së parë, plotësimin e tyre dhe krijimin e aktiviteteve specifike jashtëshkollore të gatshme për zbatim. Pas përfundimit të kësaj pjese, ekipi i trajnerëve dhe të gjithë mësimdhënësit në plenum shqyrtuan përgatitjet dhe dhanë komente për përmirësimin e tyre. Kjo fazë e trajnimit përfundoi me vizitë në disa lokalitete në Prilep. Filluam me një vizitë në monumentet kushtuar luftës në vitin 2001, pastaj vazhduam në muzeun “11 Tetori 1941” që është muze për Luftën e Dytë Botërore dhe shëtitja jonë e përbashkët nëpër muzetë përfundoi në muzeun e qytetit të Prilepit dhe ekspozitën e përhershme arkeologjike dhe etnologjike. Në fund të këtij trajnimi, diskutuam përdorimin e memorialëve dhe muzeve në formësimin e narrativeve kolektive të një kombi apo shteti.

Faza e tretë e programit përfshinte zbatimin e aktiviteteve nga shkollat partnere. Për këto aktivitete mund të lexoni më në detaje në artikujt që u referohen atyre pasi që të keni përfunduar këtë artikull.

Faza e katërt në program ishte takimi përmbyllës i programit i cili u mbajt në Prilep nga 1 deri më 3 dhjetor 2023. Ky takim u fokusua në vlerësimin e aktiviteteve të realizuara, si dhe vlerësimin e të gjithë procesit. Megjithatë, filluam duke marrë pjesë në webinarin “Përdorimi i tregimeve ndërvepruese të qendrës SENSE në mësimdhënien e historisë” (Qendra SENSE për Drejtësi Tranzicionale nga Kroacia). Webinarin ofroi shembuj praktikë të përdorimit të historisë gojore në mësimdhënien e historisë dhe ishte paraparë për mësimdhënës nga rajoni i ish-Jugosllavisë. Më pas, u fokusuam në prezantimet e aktiviteteve jashtëshkollore të realizuara nga shkollat partnere. Pas çdo prezantimi u analizuan arritjet, u shqyrtuan problemet dhe sfidat e ndodhura, u zhvilluan idetë apo drejtimit dhe çfarë mund të bëhej në situata të caktuara në ndonjë mënyrë tjetër. Natyrisht, u analizua qasja e Aksionit Paqësor me trajnime dhe aktivitete zbatuese dhe u bënë konkluzionet e duhura që do të na ndihmojnë në krijimin e punës sonë në këtë fushë në të ardhmen.

Pas përfundimit të programit të planifikuar për këtë vit, 2023, do të bëjmë një analizë të detajuar të tërë procesit. Disa përfundime imponohen:

nevojitet përdorimi i shtuar i të gjitha mundësive për ndërveprim më të madh të mësimdhënësve të historisë me prejardhje të ndryshme etnike;

nevojitet që të mundësohet dialog i vazhdueshëm mes mësimdhënësve për sfidat aktuale që ata kanë: programatike dhe teknike;

nevojitet gjetja e mënyrave kreative për bashkëpunimin e nxënësve nga bashkësitë e ndryshme etnike që janë të interesuar për historinë;

nevojitet mbështetja e kuadrit mësimdhënës që dëshiron të ndërtojë ura mes njerëzve.

Goran Taleski

Profesionistët e ardhshëm mjekësorë janë të përkushtuar për ndërtimin e paqes dhe promovimin e bashkëpunimit nëpërmjet hulumtimit dhe artit

SHMMQSH “Dr. Pançe Karagjozov” është një shkollë mjekësore në Shkup me paralele në dy gjuhë: maqedonisht dhe shqip. Përveç edukimit të infermierëve dhe mjekëve të ardhshëm, kjo shkollë angazhohet edhe për promovimin e vlerave sociale ndër të rinjtë në këtë shkollë.




Foto në grup me profesorët Kenan Iseni dhe Valentina Stamenkoviç

Iniciatorë të promovimit të kulturës së mosdhunës, bashkëpunimit dhe ndërtimit të paqes janë profesorët e historisë: Valentina Stamenkoviç dhe Qenan Iseni. Prej shumë vitesh, këta pedagogë kanë punuar për të bashkuar nxënësit e vitit të parë dhe të dytë, nëpërmjet realizimit të aktiviteteve jashtëshkollore.

Në bashkëpunim me Aksionin Paqësor nga Prilepi, profesorët Stamenkoviç dhe Iseni realizuan tri aktivitete me nxënës të kësaj shkolle, në periudhën tetor - nëntor 2023. Qëllimi i tyre është të inkurajojnë nxënësit dhe nxënëset që të bashkëpunojnë, të njihen me njëri-tjetrin dhe të diskutojnë për temën e multikulturalizmit në qytetin e Shkupit. Aktivitetet u realizuan me një grup prej 16 nxënësve. Pjesëmarrësit e këtij grupi patën mundësinë që të njihen me njëri-tjetrin dhe të ndërtojnë besim të ndërsjellë, dhe së bashku kanë vizituar 6 lokalitete të rëndësishme në territorin e qytetit të Shkupit, në mënyrë që në fund të punojnë në grupe, nga paralele dhe gjuhë të ndryshme mësimore, në një detyrë hulumtuese dhe kanë krijuar panele të përhershme dygjuhëshe që përfaqësojnë lokalitetet e Shkupit. Panelet janë ekspozuar në hollin e shkollës si një kujtesë e bashkëpunimit të ndërsjellë.

Qasja ndaj realizimit të tri aktiviteteve është kreative dhe gjithëpërfshirëse. Takimi i parë u mbajt në vetë shkollën, më 2 tetor 2023, me qëllim njohjen dhe fitimin e besimit. Dy mësimdhënësit kanë rolin e moderatorëve, dhe teknika e përdorur është **Vazhdo mendimin** duke plotësuar një pohim: *Shkupi është ...* Në fund të aktivitetit u prezantuan disa “kompozime”. Punësoria vazhdoi me një bisedë rreth lokaliteteve me interes për nxënësit dhe nxënëset që janë vizituar në aktivitetin e dytë.

Më 14 tetor 2023 u realizua aktiviteti **Unë si turist**. Grupi vizitoi 6 lokalitete të ndryshme me histori të ndryshme kulturore dhe historike. Qëllimi ishte njohja e grupit të nxënësve me të kaluarën multikulturore të qytetit të Shkupit. U vizituan lokalitetet: Xhamia e Mustafa Pashës, Qendra Memoriale e Holokaustit të Hebrenjve të Maqedonisë, Muzeu i Luftës Maqedonase për Pavarësi, Shtëpia Përkujtimore e Nënë Terezës, Muzeu i Qytetit të Shkupit dhe vendi për ekskursionet Matka, ku vizituan Manastirin e Fjetjes së Shën Mërisë. Kjo shëtitje kulturore-historike u vlerësua shumë nga grupi i nxënësve, jo vetëm për faktin se mësuuan shumë informacione të reja për të kaluarën e qytetit të Shkupit dhe natyrën e tij multikulturore, por edhe për faktin se shumë nga këto vende u vizituan për herë të parë nga nxënësit.

Pas vizitës në lokalitete, grupi i nxënësve dhe nxënëseve u nda në 4 grupe (nga katër nxënës dhe nxënëse nga paralele të ndryshme me gjuhë të ndryshme mësimore) dhe atyre iu dha detyrë që të përpilonin një projekt të vogël kërkimor për të mbledhur informacion për një lokalitet sipas dëshirës së tyre. Faktet për lokalitetin janë paraqitur me fotografi dhe përshkrim në gjuhën maqedonase dhe atë shqipe. Puna e tyre kërkimore paraqitet si ekspozitë e përhershme në 4 panele të mëdha në sallën e shkollës.

Ekspozita u promovua më 6 nëntor 2023, me titullin **Shkupi nëpër të kaluarën** në hollin e shkollës. Secili grup punë bëri prezantim në gjuhën maqedonase dhe shqipe për shokët e klasës.



Shfaqja e 6 paneleve dygjuhëshe për të kaluarën historike multikulturore të qytetit të Shkupit

Ekspozita përbëhet nga 4 panele që përfaqësojnë këto lokalitete: paneli 1 - Tumba Maxhari dhe Skupi, paneli 2 - Kalaja e Shkupit dhe Ura e Gurit, paneli 3 - Çarshia e Vjetër e Shkupit dhe Tërmeti i Shkupit, paneli 4 - Goce Dellçev dhe Nënë Tereza.

Ju ftojme të vizitoni këtë ambient të vogël por shumë domethënës në shkollë, i cili mbart mesazhin e bashkëpunimit, bashkëjetesës rinore dhe promovon multikulturalizmin si forcë dhe vlerë mbështetëse në shoqërinë tonë.


Mjekët e ardhshëm kujdesen për shëndetin e njeriut, por edhe për ndërtimin e mjediseve që promovojnë dhe praktikojnë ndërtimin e paqes së qëndrueshme.

Përgatiti: Marina Gjorgjioska Kitanoska, bazuar në raportet e përgatitura nga Valentina Stamenkoviq dhe Qenan Iseni.

"Ne ndërtojmë të ardhmen!"

Mësoni historinë, ndërtoni të ardhmen! Kjo moto përshkruan më së miri atë që paraqet "Përballja me të kaluarën" dhe u shpreh fuqishëm nga dymbëdhjetë nxënës të gjimnazit "Goce Dellçev" Kumanovë dhe nga shkolla e mesme "Zef Lush Marku" Shkup dhe profesorët e tyre frymëzues Anita Zafirovska dhe Naser Miftari.

Ata filluan me online takim me pjesëmarrje, që u mbajt më 30 tetor, ku nxënësit dhe mësimdhënësit shfrytëzuan mundësinë për t'u njohur me njëri-tjetrin, për të diskutuar mbi projektin, për të shprehur pritshmëritë e tyre dhe temat me interes, dhe për t'u përgatitur për vizitat e njëri-tjetrit. Ekskursioni i parë i 14 nëntorit i çoi nxënësit në Kumanovë - qytet i batutave, argëtimit, miqësisë! Fillimisht, nxënësit vizituan muzeun e qytetit të Kumanovës dhe u kënaqën me konceptin argëtues dhe përmbajtjet e ndryshme të muzeut. Duke reflektuar shfaqjen e bashkëjetesës etnike në historinë e qytetit të Kumanovës, profesorët vazhduan: "bashkëjetesa ka qenë dhe do të jetë". Ngjashëm, nxënësit shprehën njëzëri dëshirën e tyre se "duan të jetojnë në një shoqëri paqësore, të shëndoshë ku respektohet diversiteti, ka tolerancë dhe bashkëpunim midis njerëzve, pavarësisht nga përkatësia fetare, etnike apo çfarëdo tjetër". Shëtitja nëpër qytet, deri në qendër dhe monumentet historike u dhanë nxënësve mundësi të shkëlqyer për t'u njohur me njëri-tjetrin, për të bërë miq të rinj, për t'u përfshirë në diskutime dhe për të ndërtuar respekt dhe tolerancë të ndërsjellë.



Një tjetër ditë e suksesshme mësimore u mbajt në Shkup më 21 nëntor. Dita iu kushtua të mësuarit për të kaluarën, njëri-tjetrin dhe se si ata e përfytyrojnë të ardhmen e tyre të përbashkët. Nxënësit shijuan një shëtitje të gjatë dhe emocionuese nëpër pjesën e vjetër dhe atë të re të Shkupit të lidhura me Urën e Gurit. Vizituan Çarshinë e Vjetër të Shkupit, Suli Anin, Muzeun e Çarshisë së Vjetër dhe një ekspozitë në Çifte Hamam. Më pas vazhduan në sheshin Maqedonia dhe pjesët më të reja të qytetit, pasuar nga një diskutim stimulues për rolin e historisë si lëndë mësimore, ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe llojllojshmërinë e banorëve të Shkupit. Të gjithë e vlerësuan shumë përvojën e vlefshme të mësimdhënies në terren si një hapësirë dialogu dhe mundësi unike për të ndërtuar miqësi të reja.

Në muzeun e çarshisë së vjetër - Shkup, 2023
grup nxënësish



Në Kala - Shkup, 2023
Pjesëmarrësit e takimit në Shkup

Ne mësojmë, veprojmë, krijojmë! E gjithë përvoja u përmbyll në takimin përfundimtar online më 28 nëntor nën moton e miqësisë dhe shoqërimit që do të manifestohet në krijimin e përbashkët të fanellave – duke shfaqur haptazi emocionet e tyre! Përveç ndarjes së përshtypjeve pozitive nga programi, prezantuan edhe projektin e përbashkët: figura të suksesshme historike femra. Prezantimi i tyre përfshinte personalitetet femra si Kleopatra, shenjtorja Irina, Indira Gandhi, Klara Cetkin, Teuta Arifi, Angela Merkel dhe Margaret Theçër. Ajo që filloi si dy grupe u rrit në një - të përfaqësuar në grupet e tyre kolektive të mediave sociale ku zbuluan me kënaqësi interesat e përbashkëta, krijuan miqësi të reja dhe disa tashmë filluan të planifikonin kohën e tyre të përbashkët në universitet në Shkup!

Së bashku vazhdojnë nën moton: E djeshmja është histori, sot është e tashmja, nesër vjen ardhmëria! Pa mendjen e hapur të nxënësve dhe profesorëve kjo përvojë nuk do të kishte qenë aq e suksesshme. Të gjithë theksuan se aktivitete të tilla jashtëshkollore dhe hapësira për ndërveprim janë thelbësore për ndërtimin e një të ardhmeje të qëndrueshme, demokratike dhe të begatë. Shikimi i së kaluarës së bashku dhe përjetimi i dallimeve në të tashmen ndërton kornizën për një pamje plot ngjyra dhe paqe të një të ardhmeje të përbashkët.

Përgatiti: Katarina Shmic, bazuar në raportet e përgatitura nga Anita Zafirovska dhe Naser Miftari.

Të shkruajmë historinë e së ardhmes me dashuri

Në bashkëpunim me Aksionin Paqësor nga Prilepi, profesoreshat Mejrem Kadriu nga shkolla fillore “Naim Frashëri” nga Marani, komuna e Studeniçanit dhe Ljupka Hristova nga shkolla fillore “Joakim Kërçoski”, nga Vollkova, në Gjorçe Petrov, Shkup, së bashku me nxënësit e tyre realizuan tri aktivitete në periudhën tetor - nëntor 2023, pjesë e nismës së tyre për njohje më të madhe me kulturat tona dhe ndërtimin e së ardhmes së përbashkët.

Njohja e nxënësve.

Aktiviteti i parë u zhvillua me datë 26.10.2023, në shkollën fillore të fshatit Maran. Qëllimi ishte njohja e nxënësve me njëri-tjetrin dhe zvogëlimi apo tejkalimi i paragjytimeve mes tyre, si dhe të njihen më shumë me kulturën shqiptare nga nxënësit nga Marani. Në kuadër të këtij aktiviteti, nxënësit nikoqirë, të klasës së 9-të, gatuan edhe fli (ngjashëm me gjomleze), ushqim tradicional shqiptar shumë i preferuar nga ata që e kanë provuar. Nikoqirët treguan praktikisht se si përgatitet gjatë një takimi të përbashkët, dhe më pas të gjithë hëngrën flinë dhe pjata të tjera që fëmijët i sollën së bashku në shkollë. Në kuadër të aktivitetit, nxënësit nga Vollkova mbajtën një prezantim për shkollën dhe kulturën e tyre, si dhe nxënësit nga Marani, të cilët ndër të tjera prezantuan një shtëpi të vjetër të fshatit. Mësimdhënësit u shprehën se ishte bukur të dëshmosh pranimin reciprok të specifikave kulturore të nxënësve dhe se të gjithë e shijuan aktivitetin.



Po përgatisim fli - Morane, 2023

Grupi i nxënësve së bashku me arsimtaret Ljupka Hristova dhe Merjem Kadriu

Vizitë në monumentet historike të Shkupit.

Aktiviteti i dytë u zhvillua më 07.11.2023 në Shkup. Qëllimi ishte që nxënësit e dy shkollave të mblidhen së bashku në Shkup dhe së bashku ta shohin kulturën në mënyrë më objektive pa ndasi, si dhe të kuptojnë rëndësinë dhe domethënien e monumenteve historike për të rritur ndërgjegjësimin për ruajtjen e tyre. Nxënësit u takuan në Kala, për të cilën të dy shkollat kishin bërë hulumtime në gjuhët e tyre. Ata në fakt luanin rolin e Ciceronit, duke na futur në të kaluarën. Më pas vizituan Xhaminë “Mustafa Pasha”, pas çka vizituan edhe kishën “Sv. Spas” me varrin e të madhit Goce Dellçev. Të dy objektet kanë vlerë të rëndësishme kulturore dhe janë të së njëjtës periudhë. Më pas, së bashku hulumtuan mënyrën e jetesës në Çarshi, që shërbeu si qendër e qytetit gjatë Perandorisë Osmane. Vizituan edhe Hamamin e Daut Pashës dhe objektet e tjera përreth Çarshisë, me ç’rast u diskutua edhe për figura të rëndësishme historike të asaj periudhe. Më në fund u ndalën në sheshin Skënderbe, ku u fol për Gjergj Kastriotin - Skënderbeun dhe njëkohësisht për rolin dhe rëndësinë e Goce Dellçevit. Gjatë këtij aktiviteti nxënësit kuptuan se Qyteti i Shkupit me historinë e tij nuk na ndan, por përkundrazi na bashkon në disa aspekte.



Punëtori e përbashkët në Volkovë, 2023

Vizitë në monumentet historike në Tetovë.

Aktiviteti i tretë u mbajt më 23.11.2023 në Tetovë. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte i njëjtë me atë të mëparshmin. Dëshironim që nxënësit të ndërgjegjësohen për rëndësinë e monumenteve historike dhe të përjetonin një pjesë të historisë për të kuptuar se ajo paraqet thesar të vlefshëm. Aktiviteti filloi nga fshati Vollkovë, ku u pritën nxënësit nga fshati Morani. Nxënësit punuan së bashku dhe krijuan 4 gazeta muri lidhur me aktivitetet e deritanishme. Pas prezantimeve të gjithë së bashku u nisën për në Tetovë.

Fillimisht u vizitua Manastiri i Leshkës, ku folën për historinë e vetë manastirit. Më pas vazhduan te Xhamia e Larmë në qytet, ku u fol edhe për historikun e objektit. Destinacioni i radhës ishte Hamami i Vjetër në Tetovë, kurse më pas vizita në Universitetin e Shtutit, ku drekuan së bashku. Me këtë patëm mundësinë t'u tregojmë nxënësve se si është të jesh student, që edhe vetë të ëndërrojnë të bëhen studentë kur t'u vijë koha.

Të tri aktivitetet ishin të suksesshme. Si nxënësit ashtu edhe mësuesit janë të kënaqur me procesin dhe përmbajtjen dhe janë të interesuar për më shumë aktivitete të këtij lloji. Sidomos në drejtim të tejkalimit të paragjykimëve, ruajtjes së trashëgimisë historike, si dhe ndërtimit të një të ardhmeje të përbashkët.

Përgatiti: Emrah Rexhepi, bazuar në raportet e përgatitura nga Marjem Kadriu dhe Ljupka Hristova.

Kërkimi i thesareve të humbura dhe koha e udhëtimit

Kushdo që ka thënë se historia është e thatë dhe e mërzitshme, sigurisht që nuk i ka ndjekur aventurat njëra pas tjetrës si nxënësit e SHFK “Kirill i Metodij” nga fshati Kanatllarci dhe SHFK “Braça Milladinovci” nga fshati Dobrushevë, të dizajnuara mrekullueshëm nga mësimdhënëset Frosina Gjorgjieski dhe Ana Cellkoska!



Para Heraklesë - Manastir, 2023
Mësuesja Ana Cellkoska me një grup nxënësish

Më 17 nëntor, nxënësit e shkollës fillore “Kirill i Metodij” nga fshati Kanatllarci për herë të parë u takuan me nxënësit e SHFK “Braça Milladinovci” nga fshati Dobrushevë për të kërkuar thesare të groposura në qytetin e Manastirit. Udhëtimi u organizua nga mësimdhënëset Frosina Gjorgjieski dhe Ana Cellkoska, të cilat me dashamirësi ftuan Katarina Shmicin, punëtore e paqes në Aksionin Paqësor, që t’i shoqëronte. Fillimisht nxënësve u vinte turp gjatë prezantimit me njëri-tjetrin. Por mësimdhënëset entuziaste e thyen akullin mes dy grupeve me një ushtrim aktiv “stuhi idesh” (brainstorming) mbi pyetjen “Si ta kuptoj termin fëmijëri?”. Ky shkëmbim interaktiv idesh u realizua në një rreth përballë peizazhit mbresëlënës të amfiteatrit në Heraclea. Pas një leksioni të shkurtër informues nga mësimdhënëset për kushtet e jetesës së fëmijëve nga lashtësia e deri në ditët e sotme, nxënësit u njohën me njëri-tjetrin duke diskutuar gjallërisht se si realiteti dhe përditshmëria e tyre, p.sh. për qasjen në arsim apo përgjegjësitë shtëpiake, ndryshojnë në krahasim me fëmijët e epokave të tjera. Pasi krijuan këtë sens të parë kolektiviteti, nxënësit filluan me aventurën e tyre të parë: gjueti thesari!

Duke filluar nga Heraklea, mësimdhënëset kishin fshehur foto-magnete që tregonin të gjitha pamjet historike që vizituan: Muzeun e qytetit të Manastirit, Shtëpinë e Oficerëve dhe Kullën e Sahatit. Me çdo gjueti thesari, nxënësit fituan më shumë entuziazëm, duke kërkuar në mënyrë aktive mjedisin dhe duke ndihmuar dhe bashkëpunuar me njëri-tjetrin. Muzeu i qytetit të Manastirit veçanërisht i emocionoi nxënësit. Ata u interesuan për çdo ekspozitë, ndanë ide dhe përshtypje dhe së bashku nënshkruan librin e vizitorëve në dhomat e ekspozitës të Mustafa Kemal Atatürkut. Dreka e përbashkët e përmbylli një ditë të suksesshme hulumtimi dhe ndërlidhjeje.

Filli i të menduarit i nisur në Heraklea për “fëmijët gjatë historisë” u ngrit nga nxënësit dhe mësimdhënëset në takimin e tyre të radhës më 24 nëntor në shkollën në Dobrushevë. Kësaj radhe, nxënësit prezantuan idetë e tyre se si identifikohen me fëmijët në të kaluarën. Së bashku, krijuan një hartë mendore duke nënshkruar ceket se ndërsa përmirësohen të drejtat e fëmijëve, kushtet e jetesës dhe arsimimi, vazhdojnë detyrat dhe përgjegjësitë për të mbështetur prindërit në punën dhe angazhimet e tyre. Dhe këtë herë mësimdhënëset përgatitën një tjetër aventurë; këtë herë nxënëset shijuan udhëtimin nëpër kohë!



Dhënia e certifikatave të pjesëmarrjes - f. Dobrushevë, 2023

Megjithatë, ky udhëtim nëpër të kaluarën ishte më personal sepse ishte i gjeneratave. Nxënësit ndanë një fletë pune të përgatitur në të cilën krahasonin lojëra dhe personalitete të njohura, arsimin, mundësitë e punës, aktivitetet sociale dhe pushimet me tyre, prindërit e tyre dhe gjyshërit dhe gjyshet e tyre. Ky ushtrim rezultoi me një shkëmbim të gjallë, emocionues dhe plot ngjyra, ku nxënësit i zbuluan ngjashmëritë dhe dallimet. Megjithatë, kjo e fundit çoi në biseda edhe më të frytshme, në të cilat ata me kënaqësi ia shpjegonin njëri-tjetrit lojërat apo vendet. Udhëtimi në kohë vazhdoi drejt të ardhmes së studentëve dhe ata mendojnë për trashëgiminë që duan të lënë pas vetes. Së pari, manifestuan në mënyrë krijuese ndjenjën e tyre të unitetit dhe gëzimit duke lënë gjurmë pas vetes - shenja dhe emra në duart e tyre. Më në fund, filmuan veten si “njerëz të moshuar” (me filtra digjital) dhe ndanë këshilla dhe mesazhe që donin të linin pas. Ashtu si gjyshe dhe gjyshër të vërtetë, renditën receta për ajvar dhe bakllava, zakone dasmash dhe pikturim tradicional me këna.

Por, para së gjithash, ata duan që ta lënë pas vetes atë që edhe vetë shpresojnë se do ta ndërtojnë: një të ardhme më të mirë!

Përgatiti: Katarina Shmic, bazuar në raportet e përgatitura nga Ana Celkoska dhe Frosina Gjorgjeski.

Prezantojmë

“Doracak për aktivitetet jashtëshkollore në histori për arsimin fillor dhe të mesëm”

“Doracaku për aktivitetet jashtëshkollore në histori për arsimin fillor dhe të mesëm” u dedikohet mësimdhënësve të lëndës së historisë që punojnë në shkollat fillore dhe të mesme në vendin tonë. Natyrisht, këto aktivitete jashtëshkollore mund të përdoren edhe nga mësimdhënës të lëndëve tjera apo edukatorë që punojnë në fusha tjera, nëse i vlerësojnë si dobishme.

Doracaku përmban 8 aktivitete jashtëshkollore të parapara për zbatim në distancë, duke përdorur ndonjërin nga platformat për këtë qëllim (të testuar nëpërmjet MS Teams), por mund lehtësisht të përshtaten edhe për zbatim të drejtpërdrejtë. Nëpërmjet doracakut dëshirojmë të kontribuojmë për realizimin e online-aktiviteteve për bashkëpunim ndëretnik në lëndën e historisë. Kryerja e online-aktiviteteve në një përbërje të përzier etnike nuk paraqet zëvendësim për njohjet e drejtpërdrejta, por është një variant falas që mund të mundësojë komunikim të ndërsjellë. Për secilin nga aktivitetet jashtëshkollore të doracakut, specifikohet grup-mosha për të cilën rekomandojmë atë aktivitet, si dhe koha e zbatimit të tij. Disa nga aktivitetet kanë anekse që janë zhvendosur në fund të këtij doracak.

Doracaku është përgatitur nga përvojat në kuadër të projektit “Interpretimi i historisë së përbashkët të kohës bashkëkohore”. Gjithashtu ishte edhe bashkëpunimi i parë ndërmjet Aksionit Paqësor (AP) dhe Asociacionit të Mësimdhënësve të Historisë në Maqedoni (AMHM). Nëpërmjet projektit ishte paraparë njohja dhe puna e përbashkët me anë të trajnimeve dhe takimeve bashkëbiseduese të mësimdhënësve të historisë, por për shkak të pandemisë së korona-virusit hasëm në vështirësi të mëdha gjatë realizimit të projektit. Në fazën e parë të projektit zhvilluam një Program (me të njëjtin emër si projekti) të realizuar në 4 faza, që përfshinte një trajnim dhe 3 takime bashkëbiseduese me gjithsej 42 orë pune. Programi u realizua në periudhën gusht - dhjetor 2020 në platformën Zoom. Projekti vazhdoi me hulumtimin e lartpërmendur të teksteve shkollore dhe grupi i mësimdhënësve që ishin pjesë e programit të trajnimit i hartoi aktivitetet jashtëshkollore për realizim në distancë duke përdorur platformën MS Teams, të cilat aktivitete janë përfshirë në këtë Doracak. Në muajin prill të vitit 2021, mësimdhënësit autorë të këtyre aktiviteteve i realizuan aktivitetet me fëmijë me përkatësi të përzier etnike, në grupe në të cilat ishin përfshirë nga 3 deri në 4 shkolla. Në kuadër të projektit u zhvillua edhe hulumtimi, nga i cili doli analiza e sipërpërmendur e teksteve shkollore dhe në fund të muajit maj u mbajt konferenca përfundimtare “Historia mund edhe të afrojë”, ku më në fund edhe drejtpërdrejt u njohën pjesëmarrësit e projektit. Projekti është mbështetur financiarisht nga programi “Civica Mobilitas” dhe me mbështetje nga “Kurve, Vustrov”.

Redaktorë të Doracakut janë Goran Taleski nga Aksioni Paqësor dhe Ivana Nastovska nga AMHM. Autorë të aktiviteteve në Doracak janë: Natasha Matakova - Shkolla e mesme “Dobri Daskallo”, Kavadar; Dijana Rubellova - SHM “Dimitar Vlahov”, Strumicë; Anita Zaforivska - SHM “Goce Dellçev”, Kumanovë; Kenan Iseni SHM – “Dr. Pançe Karagjozov”, Shkup; Valentina Stamenković – SHM “Dr. Pançe Karagjozov”, Shkup; Dragan Trajčev – Shkolla fillore “Rade Kratovce”, Kočan; Nikolla Tollomanoski – SHM “Riste Risteski Ričko”, Prilep; Vesna Barkova – SHF “Panko Brashnarov”, Veles; Mire Mladenovski – SHF “Tihomir Milloshevski” - Shkup; Irena Mladenovska – SHF “Mirçe Acev”, Shkup; Lupka Hristova – SHF “Joakim Kërčovski”, Shkup; Merjem Emini – SHF “Liria”, Tetovë; Harun Rexhepi – SHF “Migjeni/Bratstvo”, Tetovë; Ivana Nastovska – SHF “Dobre Jovaniski”, Prilep; Frosina Avramoska – SH.F “Kliment Ohridski”, Prilep; Ana Micevska – SHF “Braça Milladinovci” (“Vëllezërit Milladinov”), f. Dobrushevë; Dragan Dimov – SHF “Alexandar Turunxhev”, f. Kukurečan, Manastir dhe Zdravko Stojkovski – kurator në “Muzeun Maqedonia”.

Doracaku fillimisht u përgatit vetëm në botim elektronik (PDF interaktive), por për shkak të interesimit të një numri të madh mësimdhënësish të historisë, bëmë edhe një botim të shtypur. Botimi i shtypur në gjuhën maqedonase doli nga shtypi në vitin 2022, ndërsa botimi në gjuhën shqipe në vitin 2023.

Goran Taleski



Faqja e kopertinës së Manualit për aktivitetet jashtëshkollore në histori për arsimin fillor dhe të mesëm

Prezantojmë:

Botimi i dytë i librit “Rritje me Luftë”

Libri “Rritje me Luftë” është libri i parë i botuar i Aksionit Paqësor me tregime jetësore për luftën në vitin 2001. Libri u botua në pranverën e vitit 2009 dhe puna në të zgjati rreth 12 muaj. Ne ishim pjesërisht të vetëdijshëm për sfidat me të cilat u ballafaquam gjatë përgatitjes së librit dhe mbi të gjitha për vështirësitë në gjetjen e bashkëbiseduesve që do të donin të flisnin për të kaluarën e afërt konfliktuale. Por nuk ishim të vetëdijshëm për shumë sfida tjera, dhe mbi të gjitha sfida që kishin të bëjnë me përpunimin e tregimeve: transkriptimin, përkthimin dhe lekturën. Atëherë, në vitet 2008-2009, gjatë transkriptimit të intervistave udhëhiqeshim nga autenticiteti maksimal i asaj që u tha dhe i ruajtëm dialektin dhe parregullsitë gramatikore në deklaratat e tilla. Kjo çoi në intervista më autentike, por duke e bërë këtë, shumë lexues u fokusuan në këto parregullsi, në vend se në esencën e asaj që thuhej, respektivisht në thelbin dhe kontekstin që ishin më të rëndësishmet për ne. Për shkak të mungesës së mjeteve, përkthimet nga maqedonishtja në shqip dhe anasjelltas janë bërë nga miqtë tanë aktivistë, të cilët kanë bërë një punë të madhe në kuadër të mundësive të tyre. Nuk arrinim t'i përballojmë shpenzimet e lekturës.



Për arsyet e sipërpërmendura, prej kohësh kemi kërkuar mënyrë për të ribotuar librin, me korrigjime të bëra në gjuhën e intervistave dhe me korrigjim të gabimeve në përkthim. Por mbi të gjitha, ndjemë se ky libër, i cili përmban intervista me njerëz të cilët kanë qenë në moshë të re gjatë luftës, meriton një jetë të dytë.

Realizimi i gjithë kësaj u mundësua në kuadër të projektit “Forcimi i zërit të viktimave nëpërmjet përfshirjes dhe transformimit të narrativeve” të cilin Aksioni Paqësor e zbaton në kuadër të Konzorciumit të organizatave nga Kosova, Serbia, Holanda, SHBA-të dhe ne nga Maqedonia, të mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian. Menduam se ishte më e përshtatshme ta bëjmë këtë në kuadër të një projekti që fokusohet në narrativet e luftës, që paraqet element kyç për të kuptuar vuajtjet dhe nevojat e të tjerëve në kuadër të një procesi më të gjerë të Drejtësisë Tranzicionale në vendin tonë dhe në rajon.

*Ekipi i Projektit të Aksionit Paqësor
Korrik 2023*

Kopertina e librit «Rritje me Luftë» - botim i dytë

(Si) dhe a po përballet Nepali fare me të kaluarën?

Katarina Scmic, Punëtore Ndërkombëtare e Paqes me Aksionin Paqësor dhe KURVE Vurstrou

Autorja dëshiron të falënderojë znj. Bishu Kala Bandari dhe z. Dipendra Bahadur Singh për intervistat e tyre ekskluzive dhe ndarjen e njohurive të rëndësishme, dhe z. Prabhat Bhatta për konsultimin.

Fragment

Edhe pas më shumë se 15 vjetësh konflikti të armatosur midis trupave shtetërore dhe “Ushtrisë Çlirimtare Popullore” (NOA) maoiste, që përfundoi me “Marrëveshje Gjithëpërfshirëse të Paqes”, shoqëria nepaleze mbetet e shënuar nga konflikti, kurse frustrimet rriten, si te viktimat ashtu edhe mes ish-luftëtarëve, për shkak të premtimeve të paplotësuar nga elitat politike.

Hyrje

Nepali është një vend në Azinë Jugore pa dalje në det, i vendosur në Himalaje dhe, siç thonë nepalezët, është “i vendosur në sanduiç” midis Indisë dhe Tibetit/Kinës. Tridhjetë milionë banorë të Nepalit formojnë një shoqëri shumë të ndryshme në aspektin etnik, kulturor dhe fetar, me më shumë se 100 gjuhë që përdoren. Sidoqoftë, Nepali është vendi me komunitetin e dytë më të madh hindu në botë, dhe dikur ishte monarki dhe shtet hindu përpara se të bëhej shtet laik pas konfliktit të armatosur. Ashtu si në Indi, sistemi i kastës, pavarësisht se është hequr për 50 vjet, është ende i pranishëm në hierarkitë sociale, të drejtat dhe qasjen në burimet dhe pozitat publike.

“Lufta Popullore”

Në vitin 1990, pas 50 ditësh protesta civile nga populli nepalez, “lëvizja popullore” i dha fund sundimit tridhjetëvjeçar të monarkisë autokratike dhe rivendosi demokraci shumëpartiake me monarki kushtetuese. Zonat rurale ishin veçanërisht të varfra, vendbanimet e pakicave etnike dhe “kastave më të ulëta” si Dalitët që u përballën me diskriminim shekuj më parë në “sistemin socio-ekonomik feudal” (Upreti & Sapkota 2017). Gjatë zgjedhjeve të para të lira, u shfaq një e majtë politike thellësisht e ndarë. Megjithatë rezultoi në një fitore socialiste për Partinë e Kongresit të Nepalit, partitë komuniste kritikuan mungesën e ndryshimit strukturor. Pastaj partia e sapoformuar radikale komuniste e Nepalit – Maoistët, filloi luftën civile më 13 shkurt 1996.

Me kalimin e kohës, kryengritja u intensifikua dhe Ushtria Liberale Popullore, krahu luftarak i Partisë Komuniste të Nepalit - Maoistët, zgjeroi kontrollin mbi 80% të territorit të Nepalit, duke përdorur një ideologji të klasës etnike për të mobilizuar mbështetjen nga klasa punëtore, gratë dhe pakicat etnike. Sipas Dipendra Bahadur Singh¹, varfëria dhe pabarazia sociale “ndihmuan përhapjen e konfliktit të armatosur” dhe maoistët u shfaqën si të vetmit aktorë politikë që mbrojtën dhe zbatuan fuqishëm të drejtat e grave dhe pakicave etnike. Ata përjetuan emancipim, përfshirje, përfaqësim dhe pjesëmarrje të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme në organet qeveritare. Raportohet se 40% e luftëtarëve mbështetës dhe aktivë të NOA-s ishin gra, që shërbenin në pozicione drejtuese ushtarake dhe politike (Pauls et al 2019). Por imazhi i zbukuruar i “gruas së fuqishme nga Ushtria Popullore Çlirimtare (NOAH)” është vetëm një pjesë e së vërtetës. Ato gjithashtu iu nënshtruan dhunës dhe ngacmimit nga armiku, seksizmit nga shokët meshkuj dhe përjetuan vështirësi të rënda, duke përfshirë rreziqe shëndetësore gjatë lindjes së fëmijëve në mes të zisë së bukës në xhungël ose që u duhej të ndaheshin nga fëmijët e tyre “për hir të luftës”.

¹ Zyrtar për të Drejtat e Njeriut në Komisionin Shtetëror të të Drejtave të Njeriut të Nepalit

Pas përshkallëzimit të dhunës, vrasjes së civilëve, krimeve të luftës dhe ngërçit politik, veprimi autokratik i mbretit në vitin 2005 drejt monarkisë absolute dhe kontrollit ushtarak u dha aktorëve politikë arsye për t'u bashkuar. Maoistët u bashkuan me partitë demokratike kundër monarkisë. Dhe lëvizja e përsëritur e iniciuar nga njerëzit çoi në dorëheqjen e mbretit dhe nënshkrimin e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse të paqes (CPA) në vitin 2006. E megjithatë, lufta popullore rezultoi me afërsisht 15.000 vdekje, 1.300 të zhvendosur brenda vendit, 1.300 të zhdukur, së bashku me një shkatërrim të gjerë dhe paqëndrueshmërinë.



Gratë në njësitë e Ushtrisë Çlirimtare Popullore

Krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, duke përfshirë vrasjet masive, përdhunimet, rrëmbimet dhe masakrat, kanë lënë plagë dhe trauma afatgjata kolektive dhe individuale (Risal 2018, ICTJ, Upreti & Sapkota 2017).

Në vitin 2007 Nepali shpalli fundin e 400 viteve të monarkisë duke shpallur Republikën Federale të Nepalit, me kushtetutë të re të shpallur zyrtarisht në vitin 2015 (Upreti & Sapkota 2017). Në të njëjtin vit ndodhi fatkeqësia natyrore më vdekjeprurëse në historinë e vendit, tërmetet e vitit 2015, të cilët morën afërsisht 9.000 jetë dhe plagosën rreth 23.000. Bishu Kala Bhandari² theksoi se tërmeti, pandemia Covid-19 dhe rënia ekonomike e mëvonshme përkeqësuan problemet dhe ndërlikuan cenueshmërinë e viktimave të traumatizuara nga konfliktet.

Nepali pas konflikteve

Tërmeti i vitit 2015 për një moment bashkoi kombin. Kishte tranzicion të dukshëm në një republikë demokratike që të gjithë e mbështetën, domethënë një “zgjidhje e suksesshme politike e konfliktit politik” dhe riintegrimi i rebelëve u pa si aspekt pozitiv i një paqebërjeje premtuese (Singh). Megjithatë, procesi i paqes në Nepal aktualisht konsiderohet i ndenjur dhe përballet me sfida të rëndësishme³.

² Anëtar i Bordit Ekzekutiv të Forumit të Avokimit, Katmandu, Nepal, <https://www.advocacyforum.org/>.

³ <https://dashboards.sdgindex.org/profiles/nepal> (22/11/2023).

Kryengritja e armatosur u tha se synonte arritjen e barazisë ekonomike dhe sociale, zhdukjen e diskriminimit të kastës, zbutjen e varfërisë dhe sigurimin e qasjes së barabartë në arsim dhe në kujdesin shëndetësor. Megjithatë, këto probleme mbeten të pazgjidhura (Singh).

Gratë, ish-luftëtarët e NOA-s dhe pakicat etnike prisnin rritje të përfaqësimit dhe ulje të diskriminimit. Disa prej tyre qëndruan ose u bënë përfaqësues politikë, drejtues të komunitetit ose këshilltarë, duke kultivuar me besim identitetin e tyre të ri. Dhe madje edhe të zhgënjyerit besonin se kryengritja maoiste kishte merita në emancipimin e grave në Nepal. Por për shumë tjerë, politika pragmatike e elitës maoiste dhe procesi i zbatuar i paqes duket se zbulojnë se retorika e përdorur gjatë Luftës Popullore ishte vetëm një instrument i thjeshtë mobilizimi dhe kërkimi të pushtetit (Dudouet et al 2016). Asambleja e Parë Kombëtare (AK) ishte e larmishme, por e dyta tashmë shumë më pak dhe kabineti përmbante kryesisht gra nga elita e kastave të larta. Në mënyrë të ngjashme, përfshirja aktuale politike e grave është kryesisht simbolike dhe e pranueshme vetëm nëpërmjet shoqërimit me burra të elitës. Ky fakt dhe kushtetuta e vitit 2015, e cila nuk i përmbushi pritshmëritë për sa i përket autonomisë territoriale dhe pretendimeve territoriale me bazë etnike, krijoi ndarje midis disa komuniteteve etnike dhe maoistëve. (Pauls et al 2019). Hema (në Pauls et al 2019) jep përfundimin e mëposhtëm për frustrimet e ish-luftëtarëve:

Nëse motivi juaj ishte të kërkoni pushtet dhe para, pse e përfshitë njeriun e thjeshtë në luftë? [...] Na përdorët, sepse ne në fakt luftuam për të drejtat e njerëzve.

Drejtësia Tranzicionale (TT), element kyç i Marrëveshjes Gjithëpërfshirëse të Paqes, gjithashtu nuk ka arritur të japë rezultate pas 17 vjetësh. Fajtorët janë në poste shtetërore, de facto ata gëzojnë pandëshkueshmëri dhe masat e së vërtetës dhe pajtimit mbeten të pamiratuara (Singh). Komisioni i së Vërtetës dhe Pajtimit (KRT) dhe Komisionit për Hetimin e Personave të Zhdukur me Forcë nuk u krijuan deri nëntë vjet pas Marrëveshjes Gjithëpërfshirëse të Paqes dhe ishin të ngadaltë në mbledhjen e ankesave. KRT mblodhi mbi 64.000 ankesa dhe Komisioni për Hetimin e Personave të Zhdukur me Forcë 3.000 ankesa, sipas Qendrës Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale (ICTJ). Megjithatë, puna e tyre u ndërpre, punonjësit u zëvendësuan vazhdimisht dhe nuk ndoqën asnjë procedurë – asnjë identifikim i eshtrave, asnjë hulumtim, asnjë dëgjim apo raportim publik – gjë që shkaktoi vuajtje te viktimat dhe mosbesim te institucionet (Bhandari). Aspektet kryesore të drejtësisë tranzicionale kanë ngecur, siç tregohet nga “indiferenca” e shtetit (Singh). Edhe pas premtimeve të paplotësuara, së fundmi kryeministri bëri të ditur se Drejtësia Tranzicionale është sërish prioritet i qeverisë⁴. (Bhandari).

Mungesa e së vërtetës, drejtësisë dhe dëmshpërblimit, së bashku me mungesën e llogaridhënies dhe përmbylljes, i ka lënë viktimat të frustruara dhe të mbingarkuara, duke kufizuar hapësirën për t'u marrë me të kaluarën konfliktuale të Nepalit (Bhandari). Trajtimi i drejtë dhe i barabartë është çelësi për dinjitetin dhe besimin e një personi. Fatkeqësisht, perceptimi dhe realiteti material i poshtërimit të përditshëm vazhdon, duke vënë në dukje se një detyrë e tillë e imponuar është më shumë se simbolike. Të mbijetuarit që kanë kaluar nëpër tortura dhe kanë pësuar lëndime fizike, mendore, sociale dhe emocionale kanë nevojë për trajtim të shtrenjtë mjekësor dhe mbështetje psikofizike. Shpesh, të afërmit e moshuar dhe gratë nga familja e të ndjerit ose të zhvendosurve me forcë përballen me vuajtje të ngjashme, të shoqëruara nga varfërimi që pason rrëmbimin ose vrasjen e kryefamiljarit (Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale - ICTJ 2014). Kjo nxjerr në pah barrën e rëndë me të cilën u përballën veçanërisht gratë gjatë luftës, si dhe sakrificat e tyre, të cilat shpesh janë ndër më seriozet, por kryesisht të padëgjura dhe të përjashtuara nga publiku (Risal 2018). Për shembull, Programi i Ndihmës së Përkohshme - IRP, që synon të ndihmojë viktimat e konfliktit, p.sh. me shkollim dhe kompensime, përjashton kategorikisht të mbijetuarat e dhunës seksuale dhe të dhunës me bazë gjinore, respektivisht vetëm gratë (ICTJ 2014). Bhandari thekson se:

Varfëria dhe diskriminimi i vazhdueshëm prishin paqen, duke prekur veçanërisht qasjen e grave dhe grupeve të marginalizuara në shërbimet dhe burimet thelbësore. Korrupsioni, mungesa e demokratizimit në institucione dhe pabarazitë sociale kanë kontribuar në frustrimet, duke rritur rrezikun e ripërtëritjes së konfliktit.

Përkaj DDR procesit të përfunduar me sukses, të vëzhguar nga UNMIN-i në vitin 2013 dhe statusit të moderuar të vëzhgimit nga Crisis Watch⁵, ekziston rreziku që disa ish-maoistë të frustruar me aftësi luftarake guerile të ri-radikalizohen dhe mobilizohen (Parlevliet 2011, Rohstein 2020). Singh beson se gjasat e menjëhershme të veprimeve të dhunshme me kërkesa politike nuk janë të mëdha për të nxjerr

⁴ <https://thehimalayantimes.com/kathmandu/government-committed-to-bringing-those-responsible-for-grave-human-rights-violations-to-justice-pm-dahal> ; <https://www.advocacyforum.org/news/2023/09/news-af-icj.php> (22/11/2023)

⁵ [https://www.crisisgroup.org/crisiswatch/database?location\[\]=39](https://www.crisisgroup.org/crisiswatch/database?location[]=39)

në pah shkaqet e pazgjidhura të konfliktit të kaluar. Ndryshimi midis “tensionit fetar dhe atij etnik”, megjithatë, ngre shqetësime rreth konflikteve të armatosura të mundshme me bazë etnike (Bhandari, Singh). Duke pasur parasysh qeverinë e koalicionit të formuar nga ish-aktorët në konflikt, narrativet e konfliktit nuk janë të pranishme në shoqërinë e ndarë. Megjithatë, narrativet konkurruese shfaqen sepse mungon dikush që do të përpiqet të krijojë rrëfim historik koheziv. Paraqitja e konfliktit ndryshon në bazë të interesave të vetë aktorëve. Mosmarrëveshja dhe përdorimi radikal i terminologjisë mund të çojë në përçmim për “tjetrin”. Në mënyrë problematike, një diskutim i tillë mund të “arsyetojë” edhe krimet e tmerrshme të shkeljeve të të drejtave të njeriut kur t’u jepet ngjyrosje politike” (Singh).

Fatkeqësisht, këto diskutime zhvillohen pa media dhe nuk janë në skenën publike, duke kontribuar në një amnezi të mundshme kolektive në lidhje me konfliktin (Singh). Media i kushton pak vëmendje konfliktit dhe viktimave të tij, duke neglizhuar trajtimin e shkaqeve rrënjësore, kurse edhe partitë politike gjithashtu rrallë diskutojnë konfliktet e kaluara (Singh). Jo vetëm detajet dhe historitë, por edhe terminologjia e përbaljes me të kaluarën është pothuajse e padukshme. Nocionet si Drejtësia Tranzicionale (DT) dhe pajtimi janë instrumentalizuar herë pas here nga shteti dhe përdoren kryesisht nga organizatat e shoqërisë civile (CSO)⁶. Kështu, shoqatat civile vendase dhe ndërkombëtare jo vetëm që mbrojnë mbështetjen bazë për viktimat dhe përparimin në proceset e Drejtësisë Tranzicionale (DT), por gjithashtu përballen me një mur heshtjeje dhe padukshmërie. “Nuk mësohet shumë në shkollë” (Singh), duke lënë brezat e rinj me mungesë njohurish të përgjithshme, të të kuptuarit dhe ndërgjegjësimit për konfliktin, të shkaqeve dhe pasojave të tij. Ata përqendrohen në sfidat e tyre të vazhdueshme të papunësisë dhe paqëndrueshmërisë politike (Bhandari). Megjithatë, ne mashtrojmë veten nëse konfliktin e armatosur e shohim si një kapitull të mbyllur, të ndarë nga e tashmja, duke qëndruar në raft derisa dikush të gjejë kohën dhe motivimin për t’u marrë me të.

Potenciali për një rikthim në konfliktin e armatosur në Nepal ndikohet ndjeshëm nga një qasje jo e përshtatshme ndaj së kaluarës. Dhe ndërsa konflikti supozohet se ka përfunduar, çështjet e pazgjidhura shtojnë rrezikun e ripërtëritjes së tensioneve. (Bhandari).



Lila Lopçan (djathtas), tregon portretin e bashkëshortit të saj të zhdukur. Të gjitha femrat e tjera në foto kanë humbur dikë në familjen e tyre.

Autorë: Luks Font dhe Julia Fernandez Kadenas

⁶ Organizatat e shoqërisë civile gjermane dhe zvicerane janë të vetmet që përdorin termin DWP – Dealing with the Past (Bandhari).

Përballja me të kaluarën, ballafaqimi me të tashmen

Pavarësisht këtyre sfidave, organizatat e shoqërisë civile dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut si Bhandari dhe Singh punojnë pa u lodhur për të arritur paqen. Për organizatat e shoqërisë civile, procesi i ballafaqimit me të kaluarën është me rëndësi të madhe për procesin e ndërtimit të paqes në Nepal. Ata përdorin një qasje të transformimit jo të dhunshëm të konfliktit duke u mbështetur nga programe ndërkombëtare të donacioneve. Një financim i tillë mbështet trajnime të rëndësishme për të ndërtuar kapacitetin e punonjësve, lehtëson qasjen në zonat rurale dhe forcon organizatat lokale në ndërtimin e një qëndrimi të fortë dhe të qëndrueshëm. Në ballafaqimin me të kaluarën, organizatat e shoqërisë civile, si Forumi i Avokimit Nepal (the Advocacy Forum Nepal) përdorin mjete të ndryshme për të krijuar platforma për informacion, ndërveprim dhe reflektim, si për shembull, nëpërmjet tregimit të historive të jetës në komunitete dhe shkolla, dokumentimit të historive të konfliktit, teatrit, dialogëve dhe takimeve me median. Qëllimi i tyre është të mundësojnë që sa më shumë njerëz të njihen me konfliktet e së kaluarës dhe pasojat e tyre në të tashmen (Bhandari).

Që informacioni të ekzistojë, kërkohen të dhëna të qasshme. Kjo është arsyeja pse “Fushata Kolektive për Paqe” themeloi platformën “Nepal Monitor” (<https://nepalmonitor.org/>). Nepal Monitor informon përdoruesit e tij me mesazhe me tekst dhe postë elektronike në kohë reale për situatat kritike të të drejtave të njeriut dhe ofron një hartë interaktive ku përdoruesit mund të shohin se ku, kur dhe çfarë shkeljesh të të drejtave të njeriut dhe çështjeve të sigurisë kanë ndodhur. Transparenca, si dhe një publik vigjilent vendas dhe ndërkombëtar, janë çelësi për të ushtruar presion mbi faktorin politik, për të mbledhur mbështetje dhe për të mundësuar qytetarëve të marrin vendime bazuar në informacionin e marrë dhe të marrin pjesë aktive në demokraci. Mbledhja dhe shpërndarja e historive të jetës, përveç dialogut për politikën, është mënyra kyçe që organizatat e shoqërisë civile të ushtrojnë presion për të monitoruar rastet e konfliktit dhe për të mbrojtur nevojat e viktimave për të fituar të drejtat e tyre (Bhandari). Një shembull i tillë është “Akademia e Azisë për Paqe, Kërkim dhe Zhvillim”⁷ e cila ofron shërbime cilësore nëpërmjet kërkimit, menaxhimit të njohurive, si dhe mbështetjes teknike dhe trajnimeve për organizatat. Një shembull tjetër i tillë është Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale (ICTJ), e cila së bashku me raportet e saj ofron mbështetje teknike për komisionet, asistencë për organet qeveritare dhe trajnime për hetuesit.



Pjesëmarrës në seminar të organizuar nga një organizatë joqeveritare partnere e KURVE Vustrou nga Nepali
Burimi: KURVE Vustrou

⁷ <https://asianpeaceacademy.org/home-1/> , gjithashtu : <https://www.kurvevustrow.org/publikation/working-peace-nepal>

Organizatat e shoqërisë civile si Nagarik Aawaz⁸ luajnë një rol jetik në fuqizimin e grave viktime të konflikteve. Ato i informojnë viktimat për të drejtat e tyre, i drejtojnë te organizatat e viktimave dhe autoritetet përkatëse administrative, duke e lehtësuar kështu integrimin e tyre në procesin e paqes, gjë që ka një rëndësi shumë të madhe. Gjëja më e rëndësishme është që këto grupe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, të organizohen dhe të veprojnë së bashku në procesin e Drejtësisë Tranzicionale. Me një qasje holistike që fokusohet në shërimin, terapinë, tregimin dhe fuqizimin nëpërmjet trajnimit, Nagarik Aawaz sheh një lider në secilën viktimit dhe i mbështet ato që të bëhen aktiviste të paqes. Ky proces përfshin luftën kundër të qenët të pashpresa dhe stigmatizimit, duke ua mundësuar viktimave që të ngrenë zërin dhe të ndajnë historitë e tyre, siç përshkruhet në filmin e shkurtër dokumentar “Pse ne?”⁹ (Risal 2018).

Lufta post-konfliktuale dhe financiare e grave përkeqësohet nga zakonet tradicionale të diskriminimit, të cilat reflektohen veçanërisht te gratë e veja dhe nënat beqare të cilat përballen me stigmatizim të madh. Organizata “Gratë Për të Drejtat e Njeriut”¹⁰ i mbështet dhe i fuqizon këto gra duke u ofruar atyre një vend besimi, shoqërimi dhe sigurie. Kjo përfshin kapërcimin e barrierave sociale, pasi trajnerët nga klasa e mesme e lartë takojnë gra rurale që janë analfabete, ish-luftëtare dhe të mbijetuara të dhunës seksuale. “Gratë për të Drejtat e Njeriut” (WfHR) ofron trajnime në transformimin e konflikteve, për bujqësi, për blegtori, duke mundësuar ekzistencën e pavarur, riintegrimin në shoqëri dhe largimin nga kushtet e tilla të punës si në feudalizëm. Rezultati i një qasjeje të tillë gjithëpërfshirëse është bashkëpunimi i suksesshëm i grave pavarësisht identiteteve ngushtë të përcaktuara dhe rrëfimeve kontradiktore (Dietzel).

Konkluzioni

Protestat e vazhdueshme të dhunshme, dëshpërimi mes viktimave të konfliktit dhe zhgënjimi midis ish-luftëtarëve përshkruajnë një pamje të zymtë të Nepalit pas konfliktit. Ngushtimi i hapësirës për veprim të shoqërisë civile, kombinuar me mosndëshkimin de facto të krimeve të luftës, pastaj varfëria, padrejtësia sociale dhe korrupsioni janë pengesat aktuale të rëndësishme për një proces pozitiv paqeje. Marrëveshja Gjithëpërfshirëse e Paqes, Qeveria e Koalicionit, Komisioni i së Vërtetës dhe Pajtimit dhe Komisioni për Hetimin e Personave të Zhdukur me Forcë paraqesin një bazë solide për vendosjen e paqes dhe pajtimin. Kjo nuk duhet harruar, duke pasur parasysh faktin se është një bazë që shumë vendeve të pas konfliktit / ose në konflikt u mungon shumë. Megjithatë, paqja nuk ndërtohet vetëm nga një marrëveshje paqësore. Komponentët e drejtësisë tranzicionale të marrëveshjes gjithëpërfshirëse të paqes kërkojnë zbatim të menjëhershëm për të mos mbetur një konstrukt bosh. Prioriteti i sfidave ekonomike pa adresuar shkaqet dhe traumat e pazgjidhura të konfliktit e ndërlikon rrugën drejt një të ardhmeje të begatë. Aktualisht të vetmuara, por me rëndësi jetike janë organizatat e shoqërisë civile, roli i të cilave për të mbajtur të qashtë aktorët kryesorë, duke fuqizuar qytetarët, duke inkurajuar një mënyrë demokratike të të menduarit, meriton mbështetje të plotë kombëtare dhe ndërkombëtare. Është pikërisht këmbëngulja dhe guximi i tyre që mbjellin farat për të zënë rrënjë të forta, duke parandaluar përsëritjen e dhunës dhe duke mbështetur viktimat e konfliktit në rrugën e tyre drejt drejtësisë dhe paqes në Nepal.

8 <https://nagarikaawaz.org.np/>

9 https://www.youtube.com/watch?v=__ISf5nGLOk&t=496

10 <https://whr.org.np/website/>

Burimet

Bhandari, Bishnu Kala, intervistë me shkrim 22/11/2023

Dietzel, Peter, *Die Farben von Kailali*, Südasien Journal 2/2022, <https://www.kurviewustrow.org/publikation/die-farben-von-kailali> (22/11/2023).

Dudouet, Véronique and Stina Lundström, *Post-war Political Settlements. From Participatory Transition Process to Inclusive State-building and Governance*, 2016, Berghof Foundation Berlin.

ICTJ – Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale, Nepal, <https://www.ictj.org/location/nepal> (22/11/2023).

ICTJ 2014, *To Walk Freely with a Wide Heart. A Study of the Needs and Aspirations for Reperative Justice of Victims of Conflict Abuses in Nepal*, 2014, <https://www.ictj.org/publication/nepal-reparations-walk-freely-wide-heart> (22/11/2023)

Parlevliet, Michelle, “Human Rights and Conflict Transformation: Towards a More Integrated Approach” in: B. Austin, M. Fischer, H.J. Giessmann (eds.) 2011. *Advancing Conflict Transformation. The Berghof Handbook II*. Opladen/Framington Hills: Barbara Budrich Publishers. 377-404.

Pauls, Evelyn, Tripani Baijali, Lila Sharma, et al (eds.), *I Have to Speak. Voices of Female Ex-Combatants. From Aceh, Burundi, Mindanao und Nepal*, 2020, Berghof Foundation Berlin.

Risal, Susan, *Conflict affected women. No end to their suffering yet*, *The Himalayan Times*, 21.11.2018, <https://thehimalayantimes.com/opinion/conflict-affected-women-no-end-to-their-sufferings-yet/> (22/11/ 2023),

Rohstein, Emily, *Disarmament, Demobilization, and Reintegration in Nepal*, 2020, via Research Gate (22/11/2023).

Singh, Dipendra Bahadur, intervistë me shkrim 22/11/2023

Upreti, Bishnu Raj and Bishnu Sapkota, *Case Study on Nepal. Observations and Reflections on the Peace and Constitution-Making Process*, 2017, Swisspeace.



ЗА МИР | ПËР PAQE